

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dilema e Mourinhos: A do t'ia zërë Espi vendin Viniciusit në formacionin e Real Madridit?
ADRESA	https://albeu.com/sport/dilema-e-mourinhos-a-do-tia-zere-espi-vendin-viniciusit-ne-formacionin-e-real-madridit/1013756/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:01:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 07:55:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4e5fedda00afadadd8f9e6fba49dfab177780455c68dcc3ac8b0a15b22fbee59
TEKSTI	d9e762f510abd518ec535ae2049f5b0318571b928098d762cdec277f28abb0e8
PAMJA	dc3717d787d943b9a36c55fefef313310f591888ca0851f0b9193a29519598dd

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	bcad50fc841d954955ff72c32761148f963f200bb9877557845fdc35cfa01562
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9a66b9440a0861df2d438551387cc4c0076e19988df5fe9b1c9268bd2c93d904
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/bcad50fc841d954955ff72c32761148f963f200bb9877557845fdc35cfa01562>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Dilema e Mourinho: A do t'ia zërë Espi vendin Viniciusit në formacionin e Real Madridit?



Carlos Espi po i bën gjithnjë e më shumë presion Vinicius Junior për një vend në formacionin titullar të Real Madridit, teksa paraqitjet e fundit të brazilianit kanë ngritur pikëpyetje mbi formën e tij aktuale.

Sfida e fundit ndaj Elches nxori në pah edhe një herë vështirësitë e Viniciusit për të pasur ndikim në sulm, ndërsa Espi vazhdon të shfrytëzojë me efikasitet çdo minutë që i besohet nga stoli.

Gazetari i njohur spanjoll Tomas Roncero ka dalë hapur me propozimin që trajneri Jose Mourinho të lërë në stol brazilianin dhe t'i japë mundësinë e parë si titullar talentit të ri spanjoll.

Në ndeshjen ndaj Elches, Vinicius u angazhua në disa veprime ofensive, por pasaktësia në shpërndarjen e topit dhe paaftësia për të konkretizuar rastet e krijuara lanë sërish shije të hidhur.

Sulmuesi nuk mundi të ndryshonte rrjedhën e lojës përpara se të zëvendësohej, pikërisht në një fazë ku skuadra madrilene po haste gjithnjë e më shumë vështirësi.

Nga ana tjetër, Carlos Espi po tregohet një zgjidhje e artë nga bankina. Ai hyri sërish në fushë dhe realizoi golin e fitores në çastet e fundit, duke i siguruar Realit tre pikët.

Ky nuk ishte rasti i parë që 21-vjeçari linte gjurmë në rezultat. Edhe ndaj Espanyolit kishte qenë vendimtar, ndërsa në pak minutat e luajtura kundër Betisit kishte shfaqur rrezikshmëri të dukshme në zonën kundërshtare.

Roncero mendon se kontributi i Espit është më se i mjaftueshëm për t'i besuar një fanellë titullari dhe e shihet Viniciusin si lojtarin që duhet të sakrifkohet në formacion.

Debati për rolin e brazilianit vjen në një moment kur ai ende nuk i është afruar statistikave dhe impaktit që pati në edicionet e shkuara.

të fundit /



Berisha beson në pafajësinë e ish-udhëheqësve të UÇK...



Shpenzimet e Kosovës për mbrojtjen në Hagë arrijnë mbi 40 milionë...



Shtohen masat e sigurisë para Qeverisë me rrethoja metalike ...



Shtrenjtimi i tarifave "zbraz" bankat e shkollave private, ku ...



Von der Leyen: Deficiti tregtar me Kinën arrin 1 miliard euro në ditë, ...



Balliu për Gjykatën Speciale: Sfidë për të vërtetën dhe drejtësinë



Java e 4-t e Kategorisë së Parë pëson ndryshime, katër ...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Në këtë start të sezonit, Vinicius ka alternuar momente pozitive me paraqitje ku ka pasur një ndikim të kufizuar pranë portës kundërshtare, ndërsa tifozët në "Santiago Bernabeu" po shprehin gjithnjë e më hapur pakënaqësinë e tyre.

Carlos Espi iu bashkua klubit mbretëror këtë verë nga Levante dhe iu deshën shumë pak minuta për të treguar vlerat e tij.

Deri tani, roli i tij ka qenë kryesisht si zëvendësues, por paraqitjet e tij kanë ndikuar drejtpërdrejt në ecurinë e ekipit. Ai vendosi sfidën ndaj Espanyolit dhe u shfaq përsëri në momentin kyç kundër Elches.

Sulmuesi kishte realizuar 20 gola në 66 ndeshje me fanellën e Levantes dhe është i lidhur me kontratë me Real Madridin deri në 30 qershor të vitit 2031.

Tani, diskutimi nuk sillet më thjesht rreth aftësisë së tij për të dhënë ndihmesë nga stoli, por për mundësinë konkrete që të zërrë një vend në formacionin bazë.

Mourinho ka vijuar deri më sot t'i besojë Viniciusit si një prej elementëve fiks në repartin ofensiv.

Sidoqoftë, eksploziviteti i Espit i ka ofruar trajnerit portugez një alternativë të re, një sulmues me më shumë prezencë në zonë dhe me një efikasitet të lartë sa herë që aktivizohet.

Derbi ndaj Atleticos mund të shërbejë si momenti i së vërtetës për hierarkinë në sulmin e Realit. Kjo përballje e rëndësishme pritet të vërë në qendër të vëmendjes vendimin e Mourinhos mbi formacionin.

Trajneri tani ndodhet përpara një zgjedhjeje: t'i rikonfirmojë besimin Viniciusit apo t'i shpërblejë formën fantastike të Espit me një startim në një ndeshje kaq të rëndësishme.

Espi po troket fuqishëm në derën e titullarit përmes golave dhe paraqitjeve të tij, teksa Vinicius përballet me detyrën e vështirë për të rigjetur impaktin ofensiv që e ka karakterizuar në të shkuarën.

Derbi ndaj Atletico Madridit do të tregojë nëse Mourinho do të ruajë hierarkinë ekzistuese në repartin e sulmit apo do të ndërmarrë ndryshime në formacionin e tij.

Shtuar më 16.09.2026 09:55


Tags: Carlos espi , Elche , la liga , real madrid , Vinicius Junior



Java e 4-t e Kategorisë së Parë pëson ndryshime, katër skuadrat kryesore...



Conte në radar për stolin e United, Carrick nën presion



Szoboszlai i jep fitoren Liverpoolit me një gol mjeshtëror ndaj Tottenha...



Sonte nis Europa League: Milan-Benfica supersfidë, në aksion Granit Xhaka d...




Sfida delikate për Pogradecin dhe përballja Bylis-Besëlidhja, ja çfarë...



Mbappe dhe Vinicius injorojnë fanellat e fushatës së Realit, gjesti i tyre ngj...



Barcelona refuzon ofertën e Liverpoolit për De Jong dhe kërkon 70 milionë euro



Samuel Umtiti reagon ashpër ndaj deklaratës së Mbappes për Topin e Art...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Kategoria

Linget

Tags

Moti

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.